

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU KORÇE
KOMUNA LIBONIK

Tel: 0355 861 22947

Adresa : Libonik, Korçe

Libonik Pa. 110 12014

K O N T R A T E

NR. 5

"Nderim shkolla CU fshati Pocese, Komuna Libonik"

Lidhur sot me daten: 27/01/2008 ne bazë të kushteve të përcaktuara në dispozitat e Kodit Civil mbi s.

Komunes Libonik e përfaqësuar nga Kryetari i saj Z.Petrit Kupe ,përfaqësues i vetem ne rolin e investitorit qe me poshte do te quhet "Autoriteti Kontraktor"

Dhe

Firma e perbashket : "Alba Korça 2002" shpk me seli : Bulgarec Objekt privat prane qendres komunitare Bulgarec, Korçe Me Nr Nipt : K 34004003 T - "Vitdev -Co" shpk me seli : Drenove Mborje, Gdine dy kateshe ne rrugen Nacionale Korçe Mborje , Korçe me Nr Nipt : K83926001F te qualitoria ketej e tufje "Kontraktoret"

Celbija e kesaj kontrate per punime me matje me çmime te përdryshueshme (Kontraktori eshte i detyruar te ruaje pa asnje ndryshim çmimet per njesi te përcaktuara ne oferten e dorezuar) mbeshitetet ne Ligjin Nr 9643 Date, 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.1 Dat.10.01.2007 "Per miratimin e Rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.

Neni 1
Objekti i kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte: *"Nderim shkolla CU fshati Pocese, Komuna Libonik"*

Neni 2
Vlera e kontrates

Kontrata lidhet me nje vlore totale: 13.796.377 (trembedhjete milion e shtateqind e nentehjete e gjatme mije e troqind e shatehjete e shtate) leke me IVSH

Neni 3
Afati i kontrates


Afati maksimal i perfundimit te punimeve eshte 180 (njqind e tetedhjte) dite kalendarike nga data e lidhjes se kontrates

Neni 4
Gjuha e kontrates

Gjuha ne te cilen perpilohet kontrata eshte Gjuha Shqipe.

Neni 5
Perkufizime

- 5-1 "Preventiv" jane vellimet e punimeve te plotesuara me çmime pjese perberese e ofertes.
- 5-2 "Skicë (vizatime)" perfsihjne projektet dhe te dhenat te tjera te paraqitura ose te miratuara nga Autoriteti Kontraktor per permbushjen e Kontrates.
- 5-3 "Mbikqyresi i punimeve" eshte personi kompetent i emeruar nga Autoriteti Kontraktor dhe qe i eshte njoftuar Kontraktorit i cili eshte pergjegjes per mbikqyrjen e realizimit te punimeve dhe administrimin e kontrates.
- 5-4 "Drejtor Teknik i Punimeve" ne objekt eshte personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor ,perfaqesues i Kontraktorit ,pergjegjes per kryerjen dhe perfundimin e punimeve ,per te cilen Kontraktori eshte i detyruar ti konfirmoje Autoritetit Kontraktor emrin e tij.
- 5-5 "Specifikimet" jane karakteristikat e punimeve te perfshira ne projektet e zbatimit ne dokumentat standarte te tenderit dhe çdo modifikim ose shtese e bere dhe e miratuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktor
- 5-6 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 5-7 "Çmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e punës dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 5-8 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vertetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 5-9 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e papefunduar në përputhje me kontratën.
- 5-10 "Data e fillimit" eshte data kur kontraktori do të filloje punimet ne kantier.
- 5-11 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin
- 5-12 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 5-13 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.



do të thotë nënshkruarit e kontratës.

Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që faktikon punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.

5-16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

5-17 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim, i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

5-18 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

5-19 “Standarde të kualitetit” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

5-20 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

5-21 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rricojojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Dokumentat e tenderit janë pjesë peberse e kësaj kontrate.

Neni 6 Komunikimi

6-1 Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektív vetëm pasi të dorëzohet.

Neni 7 Prona Intelektuale

7-1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përklasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjyqimit të tij.

7-2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i

qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktori.
Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

7-4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimin e kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim

Neni 8 Mbikqyesi i punimeve

8-1 Mbikqyesi i punimeve do të zgjidhet nepërmjet procesit të prokurimit elektronik sipas kërkesave dhe kushteve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor.

8-2 Detyrat e mbikqyresit të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe ato janë:

Në rast se mbikqyesi do të ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.

Neni 9 Personeli i Kontraktorit

9-1 Kontraktori do të punësojë vetëm personelin e deklaruar në oferte për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyesi i punimeve.

Mbikqyesi i punimeve do t'i propozojë Autoritetit Kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontraktorit

9-2 Në qoftë se Mbikqyesi i punimeve i kërkon Kontraktorit që të largojë një person i cili është antar i personelit ose i fuqisë punëtore të Kontraktorit duke theksuar arsyet Kontraktori do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

9-3 Drejtori Teknik i Punimeve të objektit do të jenë inxhinieret sikuader janë dhe në licensat e shpallura.

Detyrat e Drejtorit Teknik të punimeve janë si më poshtë:

- Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit.
- Dokumentacionin teknik që është i detyrueshem të mbahet në objekt.
- Korespondencën zyrtare me Mbikqyresin e punimeve
- Ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve.

... i pranishem ne te gjitha fazat e realizimit te objektit ,zbatimin e punimeve,dorezimin dhe likuidimin e objektit.

9-4 Ne rast se ndryshohet Drejtori Teknik i Punimeve Kontraktori duhet detyrimisht te lajmeroje Mbikqyresin e punimeve i cili ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor

Neni 10 Detyrimet e Kontraktorit

10-1 Kontraktori do te kryeje punimet ne perputhje me projektet e ndryshimet e miratuara dhene nga Autoriteti Kontraktor dhe ne perputhje me K.I te zbatimit te R.SII -se.

10-2 Drejtori Teknik i Punimeve ne kantier eshte i detyruar te mbaje ditarin e objektit ku do te perfshihen te gjitha punimet e kryera dhe urdherat e dhena per zbatimin e projektit .

Ky ditar ne çdo kohe do ti vihet ne dispozicion Mbikqyresit te punimeve ,grupit te Kolaudimit dhe Autoritetit Kontraktor

10-3 Kontraktori do te kryeje punime me nen/kontraktore vetem pasi te kene mare miratimin nga Autoriteti Kontraktor .

Maredheniet e nen/kontraktorit do te regullohen nepermjet nje mareveshje e cila percakton qarte nen/kontraktorin dhe ne çdo rast eshte e detyruar te respektoje te gjitha detyrimet e kontrates se Kontraktorit.

Pergjegjes ndaj Autoritetit Kontraktor mbetet gjithmone Kontraktori kryesor i punimeve.

10-4 Kontraktori ka per detyre te ruaj projektin dhe te mos e perdore ate ne projekte te tjera jashte ketij tenderi.Gjithashtu te mos jape asnje informacion (botim artikujsh apo fotografish) mbi securine e punimeve pa lejen e Autoritetit Kontraktor

10-5 Kontraktori eshte i detyruar te mare te gjitha masat per te kufizuar ndotjen e ambientit duke mare te gjitha masat.

10-6 Kontraktori eshte i detyruar te perdore te gjitha mjetet e sinjalistikes rrugore per punime ne rruge me qellim disiplinimin e trafikut te mjeteve dhe kalimtareve ne objektin e nderimit.

10-7 Kontraktori eshte i detyruar te paise punonjesit e tij ne objekt me uniforma ne te cilat te jene shprehur shenjat dalluese te shoqerise Kontraktuese.

10-8 Ne rast te mos respektimit te dispozitave te parashikuara ne pikat 10-5,10-7 te mesiperme Mbikqyresi i Punimeve i ben njoftim Kontraktorit per respektimin e detyrimeve te shprehura me lart.

Ne rast se Kontraktori nuk mer masa Brenda 10 diteve nga marja e njoftimit atehere Mbikqyresi i punimeve i propozon Autoritetit Kontraktor aplikimin e nje penaliteti ne mases 50.000,deri 200.000 leke penalitet i cili do te mbahet nga situacioni pasardhes qe do te paraqiten per likuidim

Neni 11

Testimet dhe Inspektimet

11-1 Kontraktori është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyresi i punimeve.

11-2 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Koston e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

11-3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

11-4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

11-5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirtojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 12

Ngritja e Kantierit

12-1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

12-2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyresi i Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 13

Zbulimet



13-1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohet menjëherë në mënyrë të menjshme të menjshme në formë të raportit të drejtuesit të projektit për ndonjë zbulim të tillë, i cili do të mërkë udhëzimet e nevojshme të përcaktuara për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 14

Sigurimi teknik dhe mjedisor

14-1 Kontraktori është përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në kantier duke zbatuar masat korrigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin Shqiptar.

200



14-2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursojë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 15

Rreziqet e Kontraktorit dhe Forca Madhore

15-1 Kontraktori ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve deri në fund të periudhës së garancisë për defektet që mund të shfaqen në objekt sipas të cilaveve të kontratës.

Kontraktori deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve të personelit, vdekjes dhe humbje ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe pajisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit)

15-2 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, jo për fajin e tij, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

15-3 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti

15-4 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 16 Preventivi

16-1 Preventivi do të përfshijë të gjitha zerat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.

16-2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit bazuar për çdo ze pune të preventivit.

16-3 Për zerat e reja të parashikuara në preventiv përveç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo ze të ri pune.

16-4 Nen zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë

Neni 17 Negociatat dhe Amendamentet

17-1 Palet nuk do të negocojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshojë mjafitëshëm kushtet që kanë perbere bazën për zgjedhjen e Kontraktorit

17-2 Asnjë amendament ose varacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qene me shkrim me date dhe duke iu referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtese ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palet ose persona të autorizuar prej tyre.

17-3 Çdo heqje dore nga të drejtat pushtetet ose ndreqjet që mund të behen nga palet sipas kontratës duhet të behen me shkrim në të cilën të specifikohen data dhe të nënshkruhen nga pala ose nga një përfaqësues i autorizuar i pales që ben këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojnë të drejtën dhe masën net e cilën ajo lëshohet.

Neni 18 Ndryshimi I porosisë

18-1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

18-2 Nidertime shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në I PP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

18-3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:

- a) Përcaktimet e kësaj specifikimesh
- b) Korrigjime në numëruar
- c) Korrigjime në seri

18-4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pagtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruar në amendamentet e marrveshjes.

Handwritten signature

Handwritten signature

Handwritten signature

18-5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 18 te kesaj kontrate.

18-6 Çdo ndryshim i urdheruar nga Autoriteti Kontraktor do te jete detyrimisht objekt i nje process verbali (urdheri) me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor. Keto urdhera do te hartohen ne baze te rje propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ne baze te llogarive perkatese te bera nga Kontraktori dhe Mbikqyresi i Punimeve mbeshitetur ne çmimin njesi per çdo ze pune te shprehur ne preventiv.

18-7 Çdo ndryshim i punimeve te kryera ne objektin e kontrates do te shprehjet kete shprehje te punimeve dhe pasi pregatitet dokumentacioni perkates si preventive shitese vizatimet, etj. i propozohet zyrtarisht Entit qe te dergohet fondi qe te miratoje shitesen e vleres se plote si dhe per te gjetur burimet e financimit.

18-8 Nese volumet perfundimtare te punimeve te kryera ndryshojne nga volumet ne preventive dhe vlera e tyre eshte Brenda preventivit te objektit dhe fondit rezervë te parashikuar ne preventive. Investitori ngarkon Mbikqyresin per te verifikuar volumet dhe per te dokumentuar ndryshimet e mundeshme dhe mandej i miraton ato.

Neni 19 Programi

19-1 Brenda 5 diteve nga nenshkrimi i kontrates Kontraktori do ti paraqese per miratim Mbikqyresit te punimeve nje program ne te cilin tregohet menyra e kryerjes te punimeve dhe grafiku kohor.

Kontraktori do te realizoje programin sipas grafikut te parashikuar. Kontraktori ka te drejte ti propozoje Mbikqyresit te Punimeve ndryshimin ne grafikun e punimeve duke i motivuar ato.

19-2 Ne rast se mund ose lind nevoja e dorezimit te pjesshem te punimeve keto parashikohen ne grafikun e punimeve ose ne ndryshimet e propozuara dhe te miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 20 Korigjimi i Defekteve

20-1 Sa here qe gjate perudhes te zymimit te punimeve nga Mbikqyresi i Punimeve konstatohet nje defekt, Kontraktori eshte i detyruar ta korigjtojë ate brenda afatit qe i lihet me shkrim por jo me vone se 15 dite.

20-2 Gjate perudhes te garancise te punimeve Mbikqyresi i Punimeve do te njoftoje Kontraktorin lidhur me çdo defekt para mbarimit te kesaj perudhe. Per eliminimin e defekteve lihet nje afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret por jo me shume se 15 dite.

20-3 Periudha e garancise per defekt eshte 12 muaj nga data e aktit te kotaludimit te punimeve. Me perfundimin e kesaj perudhe Kontraktori paraqet kerkesen e kthimit te vleres se garancise se

punimeve e cila eshte mbajtur nga Autoriteti Kontraktor. Ky i fundit brenda 10 diteve organizon viziten ne teren ku kontrollohen realizimet e detyrave te lena nga korigjimi i difekteve te lidhura gjate periudhes te garancise se punimeve. Nese jane kryer gjithë korigjimet e difekteve atehere hartohet akti perkates i marjes ne dorëzim te objektit dhe qe shenon perfundimin e detyrimeve reciproke te kontrates se Kontraktorit dhe asaj te mbikqyrjes te punimeve.

Neni 21
Difektet e pa Korigjuara

21-1 Ne rrethete Mbiqyrjesit me Llogaritja difektet e konstatuara ne periudhen e garancise se difekteve, brenda afatit te perjashtimit, vlerat e konstatuara te shpreheseje kushtet e korigjimit te difektit dhe Kontraktorit do te paguaje kete shume se bashku me nje gjobe te vecante e cila do te jete 0.04% te vleres te kontraktuar per çdo vite vonesë. Autoriteti Kontraktor do te mbaje kete shume duke zbritur nga garancia e punimeve e cila eshte mbajtur progresivisht ne situacione.

21-2 Nese me perfundimin e periudhes se garancise Kontraktori nuk ka korigjuar difektet e konstatuara Autoriteti Kontraktor zbrit nga garancia deri ne konfiskimin e krejt garancise te punimeve.

Neni 22
Situacionet

22-1 Kontraktori do ti paraqese Mbiqyrjesit te Punimeve brenda 5 diteve te para te çdo muaji situacionet mujore progresive per punimet e kryera duke zbritur pagesat e situacioneve te meparshme garancine e difekteve, paradhenie etj, te kesaj natyre sikurse peregjohën ne kete kontrate.

22-2 Mbiqyrresi i Punimeve do te kontrolloje punen e kryer nga Kontraktori dhe do te vertetoje shumen qe do ti paguhet Kontraktorit brenda 10 diteve nga paraqitja e situacionit. Gjate kontrollit Mbiqyrresi peregjohet vleren e punimeve te kryera.

22-3 Vlera e punes se kryer do te perfshije vleren e volemve te zerave te punimeve te perfunduara dhe te shprehura ne preventiv, vleren e ndryshimeve dhe te rasteve te konpuesuara pa prekur fondin rezerve, i cili do te financohet ne situacionin perfundimtar nese ka dokumenta qe argumentojne perdorimin e tij.

Neni 23
Pagesat

23-1 Pagesat per çdo situacion punimesh do te kryen nga Autoriteti Kontraktor brenda 10 diteve nga dita e firmosjes se situacionit dhe futures tatimore nga Mbiqyrresi i Punimeve, Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktor. Pagesat e situacioneve do te kryen ne numurin e llogarise bankare te Kontraktorit Banka "Credins Bank" Dega Korçe, ne Nr 116688 te Llogarise bankate te Kontraktorit Vildev - CO shpk

Per vitin 2014 do te paguhet punimet e kryera mbeshtetur nga situacionet duke ditur qe eshte bere celja pjeserisht e fondeve prane Deges se Thesarit.

Neni 24
Rastet e Kompesuara

24-1 Rastet e kompesuara per te cilat vonesa justifikohet do te konsiderohen si vijojne:

a-Mbikqyresi i Punimeve urdheron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet),specifikimet ose udhezimet e nevojshme per kryerjen e punimeve ne kohen e caktuar.

b-Mbikqyresi i punimeve udhezoi Kontraktorin per te zbuluar punimet e fshehta ose per te kryer prova pas kryerjes te punimeve.

c-Autoritetet Publike ose Autoriteti Kontraktor shkaktojne vonesa ne lirimin e sheshit te nderimit per Kontraktorin.

d-Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye leshimin e certifikates se marjes ne dorezim.

24-2 Kombesimi i rasteve te sipermendura do te behet si vijon:

Per vonesat e permendura ne pikat 24-1 (a,b,c,d) Autoriteti Kontraktor do te njohet shtyrjen e dates se perfundimit te punimeve nbi ate te parashikuar ne kete kontrate.

Neni 25

Taksat

25-1 Kontraktori eshte i detyruar te paguaje te gjitha taksat ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

25-2 Per taksat e peraktuara ne legjislacionin qe ka hyre ne fuqi 28 dite para dates se hapjes se tenderit,te cilat Kontraktori duhet ti kete marre parasysh ne vleren e kontrates.Autoriteti Kontraktor nuk do ti njohet shtese pagese.

Neni 26

Demshperblimi per Vonesat

26-1 Kontraktori do te paguaje Autoriteti Kontraktor demshperblim per vonesat te marra nje lirimie e punimeve ne masen 0.4% ne dite te vleres koresponduese te mbetur pa te zbatuar nga qmimi total i kontrates por jo me pak se 25% te vleres se saj.

26-2 Autoriteti Kontraktor do te zbrese demshperblimin per vonesat nga pagesa e fundit e Kontraktorit.

Neni 27

Garancia e Difekteve

27-1 Garancia e difekteve do te jete 5% e vleres te kontrates qe do ti mbahet nga cdo situacion Kontraktorit si garanci per cilasine e punimeve shumta e cila do te paguhet mbas perfundimit te periudhes te garancise te punimeve duke mare parasysh edhe sanksionet e parashikuara ne piken 21 te kesaj kontrate.

Neni 28

Kostoja e Riparimeve

28-1 Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të perdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marjen në dorëzim si dhe gjatë afatit të garancisë së defekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij në qoftë se humbja dhe dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

28-2 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kohës së punës nëse janë për shkak të mospërputhjes së kontratës ose të punës jo të cilësore të Kontraktorit do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

Neni 29

Marja në Dorëzim e Punimeve

29-1 Kontraktori pas përfundimit të punimeve njofton me shkrim Mbikqyresin e Punimeve dhe Autoritetin Kontraktor. Nëse Mbikqyresi nuk ka vërejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Kontraktori pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraqet brenda 30 ditëve Mbikqyresit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjen përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyresi i Punimeve mbas verifikimeve brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij ja paraqet të gjithë dokumentacionin Autoritetit Kontraktor.

29-2 Mbas marrjes të gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit të kohës së punës të gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kohës së punës Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të kontratës. Nga data e aktit të kohës së punës fillon periudha e garancisë së punimeve.

29-3 Në fund të periudhës së garancisë të punimeve Mbikqyresi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të veprës objekti i kësaj kontrate.

Neni 30

Zgjidhja e Kontrates

30-1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktori i tjetër përfaqësojnë të dy palët në shkeljet themelore të saj.

30-2 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

a-Kontraktori nuk fillon punën brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, si edhe në rastet kur ndalohen punimet me shumë se 10 ditë kur nuk parashikohen në programin e punës dhe ndalimi i punimeve nuk është i autorizuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.

b-Mbikqyresi i Punimeve urdheron pezullimin e punimeve duke njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktorin.

c-Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindertimit ose bashkimit të shoqërisë.

d-Kontraktori vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigjimet e difekteve te propozuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Neni 31
Pagesa pas zgjidhjes se Kontrates

31-1 Ne rast se kontrata priset nga Autoriteti Kontraktor per aresye objektive Mbikqyresi i punimeve do te leshoje nje qertifikate per vleren e punes se kryer duke zbritur pagesat e marra deri ne daten e leshimit te qertifikates.

Neni 32
Pasuria

32-1 Te gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara per realizimin e objektit do te konsiderohen si prone e Autoritetit Kontraktor ne rast prishje te kontrates

Neni 33
Zgjidhja e Mosmarveshjes

33-1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do te zgjidhin me mirekuptim qdo mosmarveshje qe do te linde gjate realizimit te kesaj kontrate.

33-2 Ne rast se palet nuk bien dakort atehere per sqarimin e mosmarveshjes ngrihet nje grup i perbere nga tre eksperte .ku secila pale ka paraqitur nje ekspert kurse i treti pranohet nga te dy palet.Ne rast se problemi nuk zgjidhet nga grupi i ekspertieve atehere palet do ti drejtohen Gjyqates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Korçe.

Neni 34
Legjislacioni baze

34-1 Ligji Aplikueshem do te jete Legjislacioni Shqiptar.

Neni 35
Garancia e kontrates


35-1 Garancia e kontrates do te jete 10 % e vleres totale te objektit e barabarte me 1,379,638 (nje milion e treqind e shtatedhjete e nente mije e gjashteqind e tridhjeta e tete) leke

35-2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet ti paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim per qdo humbje te rezultuar nga dështimi i Kontraktorit ne plotesimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.

35-3 Kjo garanci do te ngurtesohet nga Kontraktorit per llogari te Autoritetit Kontraktor para nenshkrimit te kontrates.

Neni 36
Dispozita e fundit

36-1 Kjo kontrate do te quhet e vlefshme duke filluar nga data e nenshkrimit te saj nga te dy palet. Kjo kontrate v hirtim ne 3 (tre) kopje nga te cilat nje per Dosjen e Prokurimit,Nje per Drejtorine e Finances, dhe tjetra per Kontraktorin



KONTRAKTORET

Alb Korça 2002 shpk Korçe

Perfaqesuar nga

Administratori

Arijan Myrtodani

Vula

Adresa Bulevardi Korçe

Tel 0674045360

Vildev - CO shpk Korçe

Perfaqesuar nga

Administratori

Valmir Myrtodani

Vula

Adresa Drenove Korçe

0692083083

AUTORITETI KONTRAKTOR

KOMUNA LIBONIK

Perfaqesuar nga

KRYETARI
PETRIT KUPE

Vula

Adresa Libonik Korçe

Tel:0861 22947